

"XHESI MINERAL ALBANIA" SH.P.K.

PERMBLEDHJA JOTEKNIKE

PER KËRKIM - ZBULIMIN E KROMIT

OBJEKTI "JUGU I HURDHES", QARKU DIBER,

ZONA MINERARE KONKURUESE NR. 602/1

MARS 2023

PERMBAJTJA

- a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;
- f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
- gj) informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- h) të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre;
- i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit.
- k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

a) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar;

Projekti i propozuar ka për qëllim aktivitetin e kërkim – zbulimit të mineralit të kromit në zonën konkurruese nr. 602/I në objektin “Jugu I Hurdhes”, qarku Diber, i cili parashikohet të fillojë funksionimin pasi shoqëria të pajiset me leje minerare nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Objektivat kryesore do të jenë :

Percaktimi i vendndodhjes së veprimtarisë, procesi teknologjik që do të aplikohet, ndikimi në mjedis për objektin mineral që kërkohet të pajiset me leje mjedisore, karakteristikat fizike të projektit, marrja në konsideratë e alternativave, përshkrimi i karakteristikave të mjedisit që mund të ndikohet, përshkrimi i ndikimeve të rëndësishme të veprimtarisë, parashikimi i ndikimeve direkte ose indirekte, përshkrimi i masave për zbutjen e këtyre ndikimeve, programi i monitorimit, plani i menaxhimit të mbetjeve etj...

Kuadri ligjor

KUADRI LIGJOR	
Ligji nr.57 dt.30.04.2020	PER PYJET
Ligji nr.10448 dt.14.07.2011	Per lejet e mjedisit, I ndryshuar
Ligji nr.60 dt.19.06.2014	PËR DISA NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR
Ligji nr.52 dt.19.06.2020	PËR DISA NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10448, DATË 14.7.2011, “PËR LEJET E MJEDISIT”, TË NDRYSHUAR
Ligji nr.10431 dt.09.06.2011	Per mbrojtjen e mjedisit, I ndryshuar
Ligji nr.162/2014	Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis
Ligj, Nr.68/2019, Date: 09.10.2019	Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
Ligji Nr. 10304, datë 15.07.2010	PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, I ndryshuar
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligji Nr.9908, datë 24.4.2008	PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.9362, DATË 24.3.2005 "PËR SHËRBIMIN E MBROJTJES SË BIMËVE"
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligj, Nr.37/2013, Dt.14.02.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”
Ligj, Nr.68/2014, Date: 03.07.2014	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar
ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008	Për mbrojtjen e faunës së egër, të ndryshuar
Ligj, Nr.81/2017, Date: 04.05.2017	Për zonat e mbrojtura
Ligj, Nr.46/2019, Date: 18.07.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008, “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar
Ligji Nr.10081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
Ligji nr. 8770, datë. 19.04.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike i azhurnuar
Ligj, Nr.8936, Date: 12.09.2002	Për një shtesë në ligjin nr. 8770, datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike"
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis

Ligj, Nr.39/2013, Date: 14.02.2013	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin
Ligj, Nr.152/2015, Date: 21.12.2015	Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin
Ligj, Nr.45/2019, Date: 18.07.2019	Për mbrojtjen civile
Ligj, Nr.124/2015, Date: 12.11.2015	Për efikasitetin e energjisë
Ligj, Nr.27/2016, Date: 17.03.2016	Për menaxhimin e kimikateve
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim:	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Vendim i KM, Nr.686, Date: 29.07.2015	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit. Ndryshuar
Vendim i KM, Nr.402, Date: 30.06.2021	Per miratimin e katalogut te mbetjeve
Vendim i KM, Nr.412, Date: 19.06.2019	Për miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit
Vendim i KM, Nr.505, Date: 29.08.2018	Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimin e ndotësve organikë të qëndrueshëm (NOQ)
Vendim i KM, Nr.123, Date: 17.02.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
Vendim i KM, Nr.804, Date: 04.12.2003	Për miratimin e listes se specieve te flores shqiptare, qe vihen ne mbrojtje.
Vendim i KM, Nr.177, Date: 31.03.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
Vendim i KM, Nr.248, Date: 24.04.2003	Per miratimin e normave te perkohshme te shkarkimeve ne ajer dhe zbatimin e tyre.
Vendim i KM, Nr.803, Date: 04.12.2003	Per miratimin e normave te cilesise se ajrit.
Vendim i KM, Nr.417, Date: 25.06.2014	Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit
Udhëzim, Nr.1, Date: 19.02.2018	Për miratimin e kërkesave minimale për hartimin e planeve të veprimit për zhurmat
Urdhër, Nr.234, Date: 25.05.2015	Për miratimin e udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet

Me këtë relacion sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standardet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Zbatimi i këtij projekti plotëson kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

b) planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen, në hartë topografike, sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, të shoqëruar me koordinatat sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE, të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo instalimit të pajisjeve;

Studimet e karakterit geomorfologjik ne ndihme te kerkim-zbulimit te mineralizimit te kromit, kane nje rendesi te madhe. Masivet ultrabazike te vendit tone, kane veçori te ndryshme geomorfologjike e bio-klimaterike dhe te mikroklimes, te cilat luajne rol te rendesishem ne planifikimin e sakte e mbi baza shkencore te periudhes se punimeve fushore, te perparemise qe merr ne rajone te ndryshme te masiveve ultrabazike kompleksi i metodave gjeologo-gjeokimike e gjeofizike, te parashikimit te drejte te veshtiresive qe lindin per shkak te lartesisë klimes dhe mikroklimes etj.

Zona karakterizohet nga nje terren relativisht i aksidentuar me maja te thepisura me kuote 1600 m deri 2000m , veshtersisht te kalueshme, perrenj malore dhe shpate te pjerrta me mbi 30-60° pjerrresi. Lugina dhe shpate kumulative me deluvione, aluvione dhe koluvione me xhveshmeri te kufizuar. Kushtet tekniko-minerare te rajonit, jane te pershtateshme e mjaft te favorizuara per zhvillimin e punimeve te kerkim-zbulimit te detajuar per vete diferencat ne kuote te relievit, qe variojne nga 200 – 350 m e me shume.

Objektet qe kerkohen ndodhet ne nje terren te pjerrret relativisht me pjerrresi te forte ngritje drejt jug-lindjes dhe perendimit me kuota nga 1600 m deri 2000 m. Rilievi bie ne drejtim te veriut. Siperfaqja e zones eshte e veshur me bimesi si dru ahu,pisha dhe barishte , ne kete zone nuk ka vepra arti,argjinatura apo vepra hidroenergjitike.

Bulqiza hyn ne rajonin hidrogjeografik verilindor te vendit , qe perfshihet ne pellgjet lumore Drini i Zi , govatat te mbyllura ne trajt cirqesh e amfiteatri, si dhe rrezimet massive te shkembenjeve te copetuar etj., qe jane karakteristike dalluese per terrenin e perthyer te masivet.

Ndodhen rreth 5-7 liqene malore me lartesi 1600—1900 m mbi nivelin e detit, kryesisht ne pjesen qendrore te zones.

Keto liqene kane gjatesi 100-300 m dhe thellesi 10-60 m e me shume.

Terreni eshte malor deri teper malor, i perthyer qe zoterohen nga qafa,lugjet e majat. Ne jug ngrihen vargmalet e Fush Balgjajt me lartesi 2000 m mbi nivelin e detit.

Koordinatat e pikave ne plan qe kufizojne zonen minerare Nr.602/I, ne harten 1:25 000 jane si me poshte:

KORDINATAT E ZONES MINERARE

KORDINATAT SIPAS Albanian 1986/Gauss-Kruger Zona 4		
PIKAT	Y	X
1	4436065	4606540
2	4437537	4606540
3	4437537	4605180
4	4436065	4605180
S_K = 2.002 km²		

KORDINATAT SIPAS KRGJSH		
PIKAT	X	Y
1	519315.7	4606149.3
2	520787.5	4606166.3
3	520803.3	4604806.5
4	519331.5	4604789.4
S_K = 2.002 km²		

SIPERFAQA E ZONES MINERARE ESHTË

S = 2.002 km²

Nga humultimet e bera ne zonen minerare nr.602/I ne pjesen jug-perendimorendodhet monumenti natyror “Liqenet e Kacnise”, kategoria e III-te e zonave te mbrojtura, shpallur me VKM nr.187, date 25.03.2021 “per disa ndryshime dhe shtesa” te VKM nr.303, date 10.05.2019, “Per miratimin e listes se rishikuar,te perditesuar,te monumenteve te natyres Shqiptare”. Referuar Ligjit nr.814/2017 “Per zonat e mbrojtura” subjekti duhet te rrespektoje zonen buferike me gjeresi deri ne 200 metra nga perimetri i monumentit natyror.


Per kete arsyje subjekti do te zbatoje projektin e kerkim-zbulimit duke rrespektuar zonen buferike te Monumentit Natyror “Liqenet e kacnise”, duke ju largoher 250 metra nga perimetri i monumentit.


THEKSOJME SE TE GJITHA PUNIMET E PARASHIKUARA PER PROJEKTIN E KERKIM ZBULIMIT DO TE BEHEN NE KORDINATAT E MEPOSHTME PER TE SHMANGUR ZONAT BUFERIKE TE LIQENEVE QE NDODHEN BRENDA ZONES MINRRARE KONKURUESE.

KORDINATAT SIPAS Albanian 1986/Gauss-Kruger Zona 4		
PIKAT	Y	X
1	4436065	4606540
2	4437537	4606540
3	4437537	4605180
4	4437172	4605180
5	4437021	4605357
6	4436378	4605707
7	4436065	4605787
S_K = 1.583 km²		


KORDINATAT SIPAS KRGJSH		
PIKAT	X	Y
1	519315.7	4606149.3
2	520787.5	4606166.3
3	520803.3	4604806.5
4	520439.2	4604802.2
5	520285.7	4604978.1
6	519638.3	4605320.9
7	519324.4	4605396.9
S_K = 1.583 km²		

c) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;






Az = 40°



LEGJENDE


-  Dunite
-  Hercburgite
-  Kufi gjeologjik
-  Galeri e kryer
-  Aksi i trupit xehror

PROJEKSIONI VERTIKAL I LLOGARITJES SE REZERVAVE
 OBJEKTI "JUGU I HURDHES"
 SHKALLA 1 : 500



c) informacionin për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administrojnë territorin ku propozohet projekti;

Zona, në fjalë, është një zonë e zhveshur dhe pa qendra banimi pranë saj. Qendra më e afërt e banuar është qyteti i Bulqizës 8.3 km me rreth 13500 banorë në jug dhe Nj.Ad.Selishtë 2 km në veri me rreth 1200 banorë, nga ku do të sigurohet fuqia punëtore e nevojshme për kërkim zbulim. Objekti nuk lidhet me rrugën automobilistike dhe nga rruga e egzistuese do të hapet një pjesë rruge makine dhe do të rikonstruohet ajo ekzistuese me një gjatësi rreth 10 km. Ndërsa për zonën jugore subjekti është detyruar që me investimet e veta të hapë rreth 6000 m në objektet që mendojmë të punojmë për dërgimin e mjeteve të gërmimit.



Zona e Bulqizes, nga ku do te sigurohet edhe fuqia punëtore për kerkim zbulimin e këtij objekti, është një zone me nivel te ulët ekonomik. Klima e ashpër, sipërfaqet e vogla te tokave bujqësore produktive si dhe infrastruktura ne tërësi e dobët, rënia e aktivitetit minerare etj., kane bere qe banoret e kësaj zone te lëvizin familjarisht drejt zonave te tjera te vendit si dhe ne emigracion jashte vendit.

Nder aktivitetet kryesore te popullsisë se kësaj zone, mund te përmendim: bujqësinë, blegtorinë, shfrytëzimin pyjor dhe përpunim druri, si dhe aktivitetin minerar.

Një pjese e mire e banoreve është aktivizuar si punëtore dhe specialiste ne subjektet private, qe aktualisht, janë te pajisur me leje minerare shfrytëzimi ne ish sektorët e Batrës, si ne minierat Thekën, Krastë, Batër, Lugu i Gjatë, Liqeni i Sopëve, Fushë-Lopë, etj.

Relievi

Zona e tenderuar, ndodhet rreth 8 km ne veri te qytetit Bulqizes, ne territorin e Bashkise Bulqize si she ne teritorin e bashkise Peshkopi.

Majat me te larta te zones, ndodhen ne afersi Fush Balgjajt te zones se Bulqizes dhe Shtrnges se bashkise se Peshkopise me lartesi 2020 m. Ne pergjithesi e gjithe zona eshte me lartesi mbi 1700 m mbi nivelin e detit.

Relievi eshte malor dhe i thyer. Ne zonen e kerkim-zbulimit kalon nje rrjet i dendur përroskash me prurje te qendrueshme uji. Vete përroskat pervijojne midis shpateve malore relativisht te pjerrta dhe veshtersisht te kalueshme nga njerëzit dhe mjetet.

Klima

Zona ne fjale karakterizohet nga klima tipike kontinentale, me vere te shkurter, te fresket e me reshje te pakta dhe dimer te gjate, te ftohte e me reshje te fuqishme debore. Reshjet ne vere jane ne forme shiu, shpesh me stuhi, mjaft tipike keto per zonat e thyera malore, mbi +1500 m, ndersa ne dimer, ne forme shiu dhe kryesisht debore, trashesia e se ciles, shpesh kalon mbi 1.5m, shpesh mbi 3m. Ajo fillon te bjere qe ne fundin e muajit Nentor dhe vazhdon pothuajse pa nderprerje deri ne muajin Prill. Ky teritor perfshihet pothuajse gjate gjithe vitit, por vecanerisht ne periudhen fundi i vjeshtes-fillimi i pranveres, nga erera shume te ftohta. Temperaturat ne vere arrijne deri +25 grade C, ndersa ne dimer ato shkojne deri ne -20°C deri -25°C. Kjo do te çojte ne nderprerjen e punes ne siperfaqe nga subjekti i licensuar per periudhen nentore-prill te cdo viti, periudhe e cila do te mbahet ne konsiderate gjate hartimit te projektit te kerkim-zbulimit.

Hidrografia dhe hidrogeologjia e zones

Ne zonen e kerkuar rrjeti hidrografik eshte i perfaqesuar nga pjesa siperme e rrekeve e prroskave qe ne veri bashkohen duke krijuar perroin e Shtunges ne veri, kurse ne jug krijojme perruan e Fush-Balgjaj dhe ne lindje te Rumbullit. Kjo zones ka shume liqene akullnajor , ka burime uji te pijshem me prurje nga 350 litra/sek ne dimer dhe ne vere 40-60 litra/sek te cilet nuk preken nga punimet e kerkim-zbulimit. Burimet jane me prurje relativisht te qendrueshme dhe keto perdoren per prodhime energji nga HC te ndertuar ne fshatin Kacni ne veri te zones. Ky rrjet eshte me uje te vazhdueshem, prurjet e te cileve ulen ne periudhen e veres, pasi ulet debiti i burimeve qe i furnizojne perrojte e sipermendura.. Nga pikpamja hidrografike mund te themi se objekti ka kushte te favorshme perveç momentit te renies se rreshjeve, pasi ne nje kohe te shkurter ujrat largohen nga zona.

Gjithashtu mund të themi se kushtet hidrogjeologjike të kesaj zone janë të thjeshta, pasi niveli i ujrave nentoksore është relativisht thellë dhe rrjeti hidrografik luan rol pozitiv pasi shërben si drenues i ujrave, duke krijuar kushte të pershtateshme për kryerjen e punimeve të zbulimit sot dhe për ato të shfrytëzimit në të ardhmen.

Historiku i punimeve të kerkim-zbulimit

Shenjat e para të mineralit të kromit në zonën e mineralizuar janë konstatuar në vitet '60 gjatë vërtetimeve gjeologjike të nga specialiste gjeolog të huaj (Rus) që kanë punuar në pikat e mineralizuara të kesaj zone. Në zonën e kerkuar ka patur me për disa punime të fillestare gjeologjike të karakterit të kerkim-zbulimit, ndërsa rilevimi gjeologjik të shkalleve të mëdha nuk ka pasur, i vetmi rilevim ka qenë ai i shkallës 1:25 000 të kryer në kuadër të masivit ultrabazik të Bulqizës.

Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore

Popullsia e Bulqizës dhe Nj.Ad.Selishtë është e punësuar kryesisht në minierë dhe fabrikën e pasurimit. Fushe tjetër punësimi për banorët e zonës është shfrytëzimi pyjor, përpunimi i drurit, ndërtimi, me pak tregëti, shërbimet komunale etj.

Zona e Bulqizës si gjithë zonat e tjera Veri-Lindore të vendit, vlerësohen si zone e varfer, me nivel të ulët ekonomik. Pozicioni jo i favorshëm, largësia nga qendrat e mëdha urbane, infrastruktura rrugore e dobët, kushtet klimaterike të vështira, etj. kanë çuar në një lëvizje të madhe të popullsisë drejt zonës qendrore Tiranë — Durrës, ku dhe mund të sigurohet një jetë më e mirë.

Zona në fjalë, nga ku do të sigurohet edhe fuqia punëtore për shfrytëzimin e këtij objekti, është një zone me nivel të ulët ekonomik. Klima e ashpër, sipërfaqet e vogla të tokave bujqësore produktive, largësia e madhe nga qendrat e banuara, si Bulqiza, Peshkopia e Burreli, si dhe infrastruktura në tërësi e dobët, rënia e aktivitetit minerar etj., kanë bërë që banorët e kësaj zone të lëvizin familjarisht drejt zonave të tjera të vendit si dhe në emigracion jashtë vendit.

Një pjesë e mirë e banorëve është aktivizuar si punëtore dhe specialiste në subjektet private, që aktualisht, janë të pajisur me leje minerare shfrytëzimi në ish sektorët e Batrës, si në minierat Selishtë veriore, "Liqeni i Dervishit", Shkallë, Batër, Manazdre, etj.

d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese / përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

Projektet teknike janë të hartuara në pershtatje me fazat e zhvillimit të programit minimal të punës dhe që i përkasin periudhës së zbulimit të këtij objekti. Menyra dhe koha e kryerjes së punimeve është në përputhje me kapacitetet teknike dhe organizative të shoqërisë dhe kushteve reale të objektit. Në hartimin e këtij projekti janë pasur parasysh :

- Argumentimi i punimeve të projektuara, ku jepen të detajuara lloji dhe qëllimi i çdo punimi që paraqitet në këtë program pune tre-vjeçar për të cilin subjekti i interesuar ka paraqitur interes.

- Lloji dhe vëllimi i punimeve që janë parashikuar të kryhen në këtë periudhë kohë.
- Kosto e kryerjes së punimeve
- Afatet e programuara të realizimit të tyre
- Ilustrimi grafik i punimeve të paraqitura me harta, prerje, projeksione në shkallën 1:500 dhe 1:1000 sipas rastit dhe qëllimit për çdo shesh apo trup xeheror që mendohet të preket me këto punime zbulimi.

MENYRA E PROPOZUAR PËR KËRKIM ZBULIMIN

Gjatë fazës së hartimit të projektit të kërkim-zbulimit, nga gjeologu i subjektit janë kryer në objekt vërtetime sipërfaqësore, kryesisht për të parë elementet e shtrishmerisë së mineralizimit në drejtim të thellesisë dhe grumbullimin e të dhenave plotësuese.

Lind nevoja e kryerjes së punimeve të reja të fazës paresore të kërkim-zbulimit si ; pastrime, kanale në zonën ku janë evidentuar dalje të mineralizuara, për të marrë të dhëna të reja për avancimin e mëtejshëm të punimeve të kërkim-zbulimit.

Sistemi i zbulimit të parashikuar është ai i fazës paresore të kërkim-zbulimit. Pas kryerjes së kanaleve, pastrime, puse gjeologjike në dalje të mineralizuara, do të bëhet dokumentimi dhe azhoni gjeologo-topografik i tyre, interpretimi gjeoteknik, mardhënie të shkëmbinjve rrethues, përputhja apo jo me strukturën e përgjithshme të masivit në këtë fragment të tij etj. Rëndësi të veçantë ka përcaktimi i mardhënieve me strukturën e njohur të V.B Bater, akset e zhvillimit të mineralizimit të V.B Bulqizë dhe vetë vazhdimësinë e strukturës së zonës ndërmjetesë Bulqizë-Selishtë (pjesa veriore e masivit).

Rëndësi gjatë kësaj kohe do të kushtohet gjithashtu grumbullimit dhe sistemimit të të dhenave studimore mbi objektin. Kështu do të kryhen disa matje suplementare mikrostrukture të daljeve të mineralizuara dhe shkëmbinjve rrethues, natyrës së tyre, llojit dhe përzierjes minerale.

Grumbullimi dhe analizimi i këtyre të dhenave do të bëjë të mundur zbardhjen akoma më tej të veçorive të trupit xeheror si dhe do të shërbejë si e dhënë baze për orientimin e punimeve të kërkim-zbulimit në planin e shtrirjes dhe të rënies, llogaritjen e rezervave industriale dhe gjeologjike të objektit, në baze të të cilave do të arrihet dhe në hartimin e raportit përfundimtar të zbulimit. Mbi bazën e këtyre të dhenave do të konkludohet më tej për vazhdimin dhe leverdine ekonomike të këtij objekti për fazën përfundimtare të shfrytëzimit dhe përgatitjen ose jo të dokumentacionit të lejës së shfrytëzimit.

Duhet theksuar se në këtë territor puna kërkimore do të zhvillohet në dy faza. Në fazën e parë (viti i parë dhe i dytë) do të kryhen punimet si: marshuta rikonicioni, rievim gjeologjik 1: 2 000, ndërsa do të kryhen punime sipërfaqësore kanale, pastrime, punime minerare, në fazën e dytë (viti i tretë) në varesi të rezultateve të fazës së parë, do të ribehet projekti ku do të projektohen dhe kryhen punime minerare zbulimi.

Gjatë kryerjes së punimeve të zbulimit do të zbatohet në mënyrë të rreptë rregullorja e Sig. Teknik dhe mbrojtjes në punë. Punëtoret do të instruktohen rregullisht sipas udhëzimeve dhe rregullores së Sig. Teknik dhe mbrojtjes në punë.

Në punimet e pastrimit mbi çfaqjet xeherore do të merren në konsideratë problemet që hasen në formën e shtrueshmerisë së trupit xeheror, të depozitimit të sterileve në sipërfaqe për

menjanimin e problemeve te ndotjes se mjedisit dhe lehtesimin e trajtimit te tyre pas perfundimit te punimeve.

Studimet gjeologjike dhe punimet e projektuar

Projektimi i punimeve te kerkim-zbulimit, del i nevojshme per faktin se mineralizimi kromitik ne zone nuk eshte konturuar me pare as ne planin e shtrirjes dhe as ne ate te renies, pasi nuk ka qene i njohur nga punimet rievuese te shkalles 1:50 000 dhe 1: 25 000 te kryera para viteve '90.

Mendojme qe eshte me efektiv dhe me rezultativ, sidomos per fazen ku ndodhemi, kryerja e marshutave redaksionale, rievimeve instrumentale si dhe e punimeve te lehta siperfaqesore si pastrime, kanale, pusëza etj. Ne kete menyre do te krijohet mundesia e perfitimit te te dhenave te reja mbi natyren mineralmbajtese te objektit dhe njekohesisht behet e mundur thellimi me tej i studimeve paraprake per nje kohe sa me te shkurter.

Per kete qellim jane parashikuar punime siperfaqesore dhe punime minerare si vijon:

Jane parashikuar te kryhen marshuta redaksionale rreth 5 km, rievim 1:2000 e 2 km². Kryerja e ketyre punimeve instrumentale do te shoqerohet me pastrime gjeologjike, kanale, etj me volum te pergjitheshem rreth 200 m³. Do te kryhen kanale gjeologjike per te ndjekur e konturuar daljet e trupave xeher ne gjithe zonen e dhene .

Ne zonen e dhene kemi disa dalje te vogla te xeherorit te kromit qe duhet vleresuar, qe do te thote duhet kryer punimet siperfaqesore si kanale,pastrime, puse.

Për vitin e trete të lejes, në baze të rezultateve të punimeve të kryera gjatë dy viteve të para, do të projektohen dhe kryhen punime minerare (shpime), punime të cilat do të miratohen në planin vjetor të punës.

dh) infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

Furnizimi me energji elektrike

Ne objekt nuk parashikohen investime per lidhjen me energji elektrike pasi te gjitha makinerite qe do te perdoren per kerkim - zbulimin e mineralit te kromit nuk do te funksionojne me energji. Lidhja telefonike do te jete mobile. Nuk lind nevoja per furnizim me uje teknologjik.

Sasia e ujit dhe menyra e largimit te tij

Sic eshte trajtuar dhe me lart, periferia e zones ku ndodhet objekti ka nje shperndarje karakteristike te perrenjve, prroskave, rrekeve etj. Ushqimi i vetem i prurjeve te lengeta jane rreshjet e shiut dhe debores. Tipar karakteristik i rregjimit hidrologjik eshte luhatja e theksuar e niveleve te tyre gjate vitit qe lidhet kryesisht me nivelin e reshjeve. Periudha me prurje te larta zgjat gjate muajve Tetor-Maj dhe me prurje te pakta Qershor – Shtator. Rrjedhja minimale

eshte e lidhur me rreshjet e pakta dhe avullimin e fuqishem per shkak te temperaturave te larta. Rrjeti hidrografik i perrenjve perben zonen e drenimit edhe per objektin qe do te shfrytezohet. Nga monitorimi sistematik qe do te behet prurjeve te ujit I rekomandohet shoqerise qe me shtimin e tyre te merren masa per kanalizimin dhe drenimin e tyre jashte zones ku do te kryhen punimet e kerkim - zbulimit.

Tharja e siperfaqes se vendburimit dhe mbrojtja e tij nga hyrja e ujrave kryhet me anen e krijimit te rrjetit te kanaleve kullues. Dyshemeja e ketyer kanaleve duhet te arrije deri ne shkembenjte rrethues. Kanalet vendosen ne krye te vendburimit ose gjithe perimetrin e tij duke nderprere drejtimin e rrjedhes se ujrave. Uji i grumbulluar dergohet nepermes tyre jashte kufijve te vendburimit ne perroin ose lumin me te afert.

Ne procesin e kerkim - zbulimit nuk perdoret perzierje materialesh,
Nuk perdoren kimikate sintetike apo laboratorike
Nuk perdoren lende plasese

Pershkrimi i infrastruktures se nevojshme per realizimin e projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare.

Rruge automobilistike per realizimin e punimeve te kerkim-zbulimit.

Vendburimi ndodhet 8.3 km neveri te qytetit te Bulqizes, 50km larg qytetit te Peshkopise. Nga rruga e egzistuese do te hapet nje pjese rruge makine dhe do te rikonstruktohet ajo ekzistuese me nje gjatesi rreth 5 km per lidhjen e objektit dhe kryerjen e punimeve ne zonen minerare.

Ne projektin e zbulimit eshte parashikuar qe te kryhen disa punime me karakter studimi. Kryerja e ketyre punimeve kerkon dhe hapjen e shesheve per vendosjen e materialeve dhe objekteve te tjera ne sherbim te kryerjes se punimeve. Jane llogaritur te levizen nga keto germime se bashku me pastrimet dhe punimet e tjera me karakter zbulimi rreth 354 m³ materile shkembor dhe dhera te ndryshme.

e) programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;

Bazuar ne Ligjin Minerar Nr. 10 304, datë 15.7.2010 " Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", Neni "Afati i lejes së kerkim zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometallore, qymyret dhe bitumet", ka afat vlefshmërie 3 vjet, nga hyrja në fuqi e saj. Pas kesaj periudhe hartohet raporti per shndrrimin e lejes se kerkim – zbulimit ne leje shfrytezimi. Nga sa u theksua me siper aktiviteti I kerkim zbulimit do te zhvillohet gjate tre viteve si me poshte

Fazat e kryerjes se punimeve sipas afateve.

Ne programin trevjeçar te kryerjes se punimeve ne vitin e trete te zbulimit eshte parshikuar qe keto pune qe jane paraqitur ne kete program pune te kryhen brenda nje periudhe kohore nje

vjecare, periudhe qe kerkohet edhe shtyrja e afatit kohor te lejes. Ne kete program eshte parshikuar qe punimet te kryhen sipas ketyre afateve:

Faza e pare (Marshuta, rilevime, punime) -viti i parë dhe i dytë:

Gajte kesaj faze do te kryen te gjitha llojet e punimeve te programuara ne kete faze duke i ndjekur ato hap pas hapi si; marshuta redaksionale, rilevim gjeologjik, etj. Perparesi do ti kushtohet pastrimit dhe thellimit te kanaleve gjeologjike te kryera me pare, rigjenerimit dhe thellimit te punimeve te meparshme te zbulimit nese ka, dokumentacionit gjeologjik te punimeve te kerkim-zbulimit te kryera gjate viteve te para. Ri'interpretimi i te dhenave gjeologjike me grup specialistesh do te jete nga detyrat paresore te kesaj faze. Ne varesi te rezultateve qe do te merren, do te behen edhe ndryshime qe lidhen me perfytyrimin e ri qe mund te krijohet te daljeve e trupave kromititik, ne varesi te ndryshimit te elementeve te shtrirjes zhytjes jug-lindore dhe renies se tyre.

Do te behet zbulimi i detajuar me kanale gjeologjike, pastrime dhe galeri. Natyrisht kryerja e ketyre punimeve te cilat jane te kushtueshme do te behet dora-dores duke u bazuar ne vlerësimin dhe rivlerësimin e materialit gjeologjik te grumbulluar nga dokumentimi i punimeve gjeologjike te kryera. Gjate kesaj faze punimet do te jene te perqendruara kryesisht ne aktivitetin minerar ku perfshihet perfundimi i te gjithë punimeve minerare ne objekt. Per kete faze eshte menduar edhe kryerja e galerise se kerkimit per vertetimin ne renie te trupit te mineralizuar. Lloji dhe volumet e punimeve minerare te kerkim-zbulimit jepen ne tabelen e punimeve te projektuara. Perpunimi i pjesshem e materialit gjeologjik mund te behet edhe gjate fazes se dytë.

Faza e dytë (viti i trete):

Gjate kesaj faze, në baze të rezultateve të marra gjatë dy viteve të para, do të kryhen dhe punime minerare,shpimi, do të bëhet perpunimin e materialit faktik te grumbulluar, interpretimin gjeologjik te te dhenave te grumbulluara, pergatit raportin gjeologjik se bashku me hartat, skicat dhe materialin tjetër grafik e fototgrafik etj, ne baze te te cilit do te kryhet me tej projektimi i punimeve te hapjes dhe shfrytezimit te rezervave te zbuluara.

Në fazen e trete do te behet perpunimi perfundimtar deri ne perpilimin e raportit apo relacionit qe do te diskutohet dhe do te miratohet nga organet perkatese.

ë) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;

Meqenese kemi te bejme me kerkim – zbulimin e mineralit te kromit, nuk do te kete ndertime te perkoheshme apo te perhereshme

f) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);

Sic u trajtua me lart ne kete objekt nuk do te ndertohen objekte siperfaqesore e per rrjedhoje nuk lind nevoja per perdorimin e materialeve te ndertimit. Ne objekt nuk parashikohen

investime per lidhjen me energji elektrike, nuk lind nevoja per uje teknologjik. Lende e para qe do te kerdoren per realizimin e ketij projekti jane karburantet per mjetet e punes (Diesel).

g) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth /pranë zonës së projektit;

Ne zonen e projektuar per kerkim - zbulimin prej vitesh ka zhvilluar aktivitet shfrytezimi te mineralit te kromit miniera e kromit Bulqize si edhe shume subjekte te tjera private. Jane te gjitha mundesite e lidhjes se ketij projekti me rruget, linjat e energjise elektrike (nqs do te nevoitet) etj.. me ato ekzistuese ne periferi te kesaj zone.

gj) informacion lidhur me alternativat e marra në konsideratë për sa i takon për zgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;

Procesi i perzgjedhjes se projektit, si dhe alternativat gjate hartimit te projektit/veprimtarise i jane nenshtruar procesit te konkurimit per zonen minerare nr. 602/I te shpallur nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise ne te cilen eshte percaktuar siperfaqja dhe kordinatat e vendndodhjes se projektit.

Teknika dhe teknologjia e zhvillimit te punimeve te kerkim - zbulimit mer parasysh parandalimin e rreziqeve , mjedisore. Ne rastin konkret do te behen punime te pakta me siperfaqe, gje qe minimizon shkarkimet ne ajer te pluhurave, zhurmave dhe gazrave, duke I bere ato te paperfillshme.

Ne projekt parshikohen zgjidhje teknike te punes ne raport me punonjesit qe do te punojne ne objekt dhe kalimtareve te zones. Me rritjen e numrit te punonjesve, shtimit te paisjeve teknologjike ndikimet ne mjedis do te trajtoheshin ne pershtatje me keto ndryshime.

h) përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;

Gjate funksionimit te ketij projekti nuk do te perdoren lende plasese, uje teknologjik dhe as energji elektrike. Per zhvillimin e ketij projekti si lende e pare do te perdoret vetem karburant (diesel).

i) të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;

Gjate zbatimit te projektit nuk do te linde nevoja per ndërtim te kampeve apo rezidencave.

Ne projekt jane parashikuar qe objektet e sherbimit te jene portative (te levizeshme) pasi koha e perdorimit te tyre eshte e kufizuar dhe mjaft e shkurter. Per kete qellim do te perdoren rulote qe terhiqen nga makinat dhe bajo te levizeshme. Punimet kamerale dhe ato kancelarike do te behen ne Bulqize ne zyrat e subjektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: LN-4030-11-2017
NUIS/NIPT: L721150075

LICENCË

Subjekti: D.E.A. PROJEKT	
Adresa: TIRANE, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njesia Administrative nr.7, Rruga e "Kavajes", zona kadastrale 8250, nr. pasurie 1/992+3-N4	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 02/11/2017	Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis).

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike


Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i portelit

Florinda





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 123 Prot.

Tirane, me 09.06. 2005

Vendimi Nr.5, Nr.144 Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Gëzim DAUTI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.



j) informacion për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit.

Zbatimi i këtij projekti fillon me paisjen e shoqërisë me leje kerkim - zbulimi edhe lejen mjedisore nga Ministria e Mjedisit. Sqarohje që shoqëria është e rregjistruar në Q.K.B si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi do të jenë :

- Leja mjedisore e leshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Q.K.B. pa afat
- Leja e kerkim - zbulimit e leshuar nga Ministria e infrastruktures dhe Energjisë dhe Q.K.B. me afat 3 vjet dhe me të drejte shndërrimi në leje shfrytëzimi.

k) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Lejet dhe licencat e nevojshme për projektin që shoqëria disponon janë :

- Certificate nr. 123 Prot, dt. 09.06.2005, vendimi nr. 5 nga Ministria e Mjedisit për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis
- Njoftimin e shpalljes fitues nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë nr.2826/I prot. dt.17.03.2023.

PERGATITI

"D.E.A. PROJEKT" SH.P.K.

licensuar nga Q.K.L. për shërbime ekspertize profesionale lidhur me ndikimin në mjedis.

nr. license LN-4030-11-2017

EKSPERT MJEDISOR

